FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

Solucion fiziologjik

Tretësirë me pika për hundë - 0.9%
(Klorur natriumi)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma me ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Solucion fiziologjik dhe përse përdoret
2. Përpara se të përdorni Solucion fiziologjik
3. Si ta përdorni Solucion fiziologjik
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Solucion fiziologjik
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË SOLUCION FIZIOLOGJIK DHE PËRSE PËRDORET

Solucioni fiziologjik është tretësira izotonike e klorurit të natriumit (0.9%), e cila përmirëson kongjestionin nazal duke ndihmuar në lëngëzimin e sekrecioneve të hundës.
Përdoret në rastet e kongjestionit të hundës.
Mjeku juaj mund t'ju ketë dhënë barin Solucion fiziologjik për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj nëse doni të dini pse ju është dhënë ky bar.

2. PËRPARA SE TË PËRDORNI SOLUCION FIZIOLOGJIK

Mos përdorni Solucion fiziologjik nëse keni mbindjeshmëri ndaj përbërësve të tretësirës. Nuk ka të dhëna për kundërindikime të klorurit të natriumit kur përdoret në formën e pikave për hundë në indikimin e përmendur më lart.

Tregoni kujdes të veçantë me Solucion fiziologjik:
Nuk ka të dhëna për përkujdesje të veçanta gjatë përdorimit të klorurit të natriumit në formën e pikave për hundë për indikimin e përmendur më lart.

Marrja e barnave të tjera:
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me barin Solucion fiziologjik në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Gjithsesi, nuk njihen ndërveprime farmakologjike me barna të tjera.

Përdorimi i barit Solucion fiziologjik me ushqim dhe pije:
Nuk ka të dhëna.

Shtatzënia dhe ushqimi me gji:
Mund të përdoret.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive:
Nuk njihen efekte të tilla të cilat mund të dëmtojnë vigjilencën e personit nga përdorimi i barit Solucion fiziologjik, tretësirë me pika për hundë.

3. SI TA PËRDORNI SOLUCION FIZIOLOGJIK

Solucion fiziologjik përdoret lokalisht me pika në hundë.
4 - 10 pika në ditë, të administruara në mënyrë lokale në hundë.
Foshnjet: 1 – 2 pika në secilën vrimë të hundës përpara ushqimit. Kjo ndihmon lirimin e hundës dhe lehtëson ushqimin me gji.

Në qoftë se keni përdorur më shumë Solucion fiziologjik:
Në qoftë se keni përdorur më shumë Solucion fiziologjik se sasia që duhet të përdornit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se keni harruar të përdorni Solucion fiziologjik:
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos përdorni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME TË SOLUCION FIZIOLOGJIK

Nuk janë konstatuar efekte të padëshirueshme.
Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI SOLUCION FIZIOLOGJIK

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni barin Solucion fiziologjik pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani në temperaturë mbi 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Solucion fiziologjik
Lënda vepruese është klorur natriumi.
1 ml Solucion fiziologjik përmban 9 mg klorur natriumi.
Përbërësit e tjerë të tretësirës janë metilhidroksibenzoat (nipaginë) dhe ujë i pastruar.

Përmbajtja e paketimit
Forma e paketimit – kuti me një shishe plastike 10 ml.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Mund të merret pa recetën e mjekut.

Përmbajtja. ! Kujdes.

Pika për hundë.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.Fax: 00 355 4 23 62 800
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Shtator 2013.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.